



**Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Istanbul Technical University (ITU), Turqi**

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e studentëve për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:** Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë të studimeve.

**Kohëzgjatja e bursave për studentët:** Studime–semestri i II i vitit akademik 2024 - 2025

**Numri total i studentëve:** 1

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj\* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.



**Key Action 1**  
**– Mobility for learners –**

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL IBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kurju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në ITU lëndët e njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ ju lutemi klikoni te:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t’u njohur me programin e lëndëve që ofron ITU, ju lutemi klikoni te: [ITU | Programs](#)

***Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 20 dhjetor 2024, ora 12.00***

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) dhe [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)